



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 15/12/2020

Proces-verbal

Bashkia Korçë organizon një takim me administratorët dhe anëtarë të bordit në zonat TID dhe BID në Korçë, në kuadër të diskutimit për Paketën Fiskale të vitit 2021

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë si dhe përfaqësues të zonave BID dhe TID, përkatësisht Mimoza Kame administratore e shoqatës BID, Magi Leno administratore e shoqatës TID, Luiza Bode dhe Renaldo Ibraj anëtar bordi shoqata TID, Olger Koleci anëtar bordi shoqata BID.

Në takimet e zhvilluara me përfaqësues që ushtrojnë aktivitetin e tyre në pedonalen e qytetit dhe në Pazarin e Vjetër (BID/TID) u paraqitën disa kërkesa kryesore. Veç bashkëpunimit të mirë me bashkinë dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, administratorët e shoqatës BID dhe TID listuan nevojat e tyre:

- Në të dy zonat kërkohet shtim i shërbimit të pastrimit, sidomos në orët kur lokalet mbyllin aktivitetin e tyre.
- Në zonën TID kërkohet nga ana e policisë bashkiake të ushtrohen më shumë kontrolle për mjetet që hyjnë në zonën e pazarit.
- Në zonën BID lëvizja e biçikletave dhe motorave elektrik është kthyer gjithashtu në shqetësim.

- Prania e qenëve endacak ishte problem në të dy zonat, të cilat gjithashtu kërkuan edhe një rregullore të mirëpërcaktuar për vendosjen e reklamave dhe tavolinave.
- Përsa i përket taksave dhe tarifave vendore në zonën TID ishte problem zënia e hapsirave publike gjatë dimrit pasi në këtë zonë të pazarit nuk lejohen rrethimet me barrier ndarëse as pedanat, për këtë arsye u kërkua që të rishikohet tarifimi në këtë zonë.
- Kërkesë e përbashkët për të dyja zonat ishte që në rast se do të ketë një mbyllje të dytë të mos ketë tarifime për këtë periudhë.